

“Gallery Albanian Restorant” Shpk Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

“Gallery Albanian Restorant” Sh.p.k-L61415028A
Bulevardi "Bajram Curri", TIRANE

SHENIME PER DEKLARIMET FINANCIARE

I. Organizimi, Objekti dhe Kontributet, Pronesia mbi aktivet, Kapitali dhe Administrimi

Organizimi

Shoqeria “Gallery Albanian Restorant” sh.p.k eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne dt.03.02.2016. Kapitali i shoqerise eshte ne vleren 100.000 leke dhe ortaku i vetem i shoqerise eshte shoqeria “Albeton 5” sh.p.k me 100% te kuotave.

Ne date 10.11.2021 eshte riemeruar Z. Gjergji Toshi si Administrator I shoqerise.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

Objekti dhe Kontributet

Shoqeria “Gallery Albanian Restorant” sh.p.k ka si objekt :- Aktivitet ne fushen e Bar - Restorant - Piceri, tregtim me shumice e pakice i produkteve ushqimore, bujqesore blektorale, pije freskuese, alkalike etj. Cdo lloj aktiviteti tjetër tregtar, qe eshte i lejueshem ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise. Kontributi ne shoqeri perfaqesohet nga kapitali i ortakut te vetem, shoqeria “Albeton 5” sh.p.k.

Pronesia mbi Aktivet

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne ambientet e marra me qira.

Kapitali

Kapitali i shoqerise prej 100.000 leke eshte kapitali i regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Administrimi

Shoqeria drejtohet nga Administratori i pergjithshem.

II. Zbatimi i rregullave te mbajtjes se kontabilitetit

Kontabiliteti eshte organizuar dhe mbajtur ne pajtim me kerkesat e ligjit “Per kontabilitetin”. Veprimet jane regjistruar ne menyre kronologjike dhe te kompjuterizuar. Çdo veprim eshte mbeshtetur ne dokumenta justifikuese. Veprimet jane ngurtesuar me 31 dhjetor 2022.

III. Politikat Kryesore Kontabel

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me Ligjin Nr.25, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe me Standartet Nderkombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera sipas “parimit te te drejtave te konstatuara”. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (lekë). Veprimet jane hedhur ne menyre kronologjike dhe te kompjuterizuar ne programin “FINANCA 5”. Veprimet jane ngurtesuar me 31.12.2022.

“Gallery Albanian Restorant” Shpk Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara, mbështetur ne dokumentacionin justifikues. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e përfitimeve. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve, dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura, duke u mbështetur ne dokumentacionin justifikues.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual, bazohet mbi fitimin e tatueshem, i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2022 eshte 15 % .

Kërkesat për t’u arkëtuar

Kërkesat për t’u arkëtuar, llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t’u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t’u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t’u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin “tepricë nga rivlerësimi”. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazen e vleres se mbetur per aktivevet e qendrueshme. Normat e perdorura jane sipas ligjit 8438 dt.28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat” per te gjitha aktivet qe disponon shoqëria me perqindjet respektive te vleres se mbetur.

Gjendjet e inventaret

Vlerësimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen koston e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjate shitjes se mallrave shkarkimi behet me kosto mesatare.

Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me koston e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

“Gallery Albanian Restaurant” Shpk Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

4. Aktive Afatgjate Materiale

Te trupezuara Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjate materiale 9.855.836 leke e cila perbehet si me poshte:

	Ndertesa	Makineri e pajisje	Paisje Informatike	Zyre &	Mjete Transporti	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>						
Gjendje 01.01.2022		11,703,927	1,030,962		-	12,734,889
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-	-
Gjendje 31.12.2022	-	11,703,927	1,030,962		-	12,734,889
<i>Amortizimi</i>						
Gjendje ne 01.01.2022		2,656,350	222,703		-	2,879,053
Shtesa llogaritur	-	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-	-
Gjendje ne 31.12.2022	-	2,656,350	222,703		-	2,879,053
Vlera neto 01.01.2022	-	9,047,577	808,259		-	9,855,836
Vlera neto 31.12.2022	-	9,047,577	808,259		-	9,855,836

Ne aktiv te bilancit paraqiten te gjitha aktivet per te cilen shoqeria ka titull pronesie, ato paraqiten te vleresuara me vleren e tyre te hyrjes ne shoqeri, klasifikimi i tyre ne elemente te vecante eshte ne perputhje me rregullat e percaktuara nga ligji “Per Kontabilitetin”. Per te gjitha ndryshimet ne aktivet afatgjate materiale ekziston dokumentacioni perkates.

Amortizimi

Per periudhen raportuese shoqeria nuk ka llogaritur amortizim.

5. Aktive Qarkulluese shoqeria ka ne dispozicion nje shume prej 1.583.332 leke nga te cilat:

5a. Gjendje inventari dhe ne proces Shoqeria ka gjendjen e meposhtme te inventarit me 31.12.2022:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Materiale te para	468,196	510,767
Mallra per rishitje	-	-
Totali	468,196	510,767

5b. Kerkesa per arketim mbi debitorët 253.160 leke perfaqeson detyrime per tu arketuar pas dates 31.12.2022:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Llogari / Kerkesa te arketueshme	67,840	1,640
Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	185,320	228,319
Totali	253,160	229,959

“Gallery Albanian Restorant” Shpk Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Tatim fitim i mbipaguar	185,320	185,320
TVSH kreditore	0	42,999
Llog. Dogane		
Totali	185,320	228,319

5c. Likuiditete dhe vlera arke te tjera perfaqeson gjendjen ne banke dhe ne arke me 31.12.2022. Shoqeria ka llogari likuiduese ne BKT.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Para ne dore	547,450	87,925
Para ne Banka	382,366	78,043
Totali	929,816	165,968

Likuiditetet jane paraqitur ne bilanc me gjendjen e llogarise bankare ne daten e fundit te 31 Dhjetorit 2022, e cila eshte e njejte me ekstraktin e fundit te bankes per kete periudhe si dhe llogarite ne valute jane konvertuar me kursin e Bankes Shqiperise per kete date.

6. **Kapitalet e veta** me ndryshimet perkatese paraqiten ne tabelen me poshte:

	<u>Viti 2022</u>	<u>Viti 2021</u>
Kapitali	100,000	100,000
Rezerva Ligjore	-	-
Rezerva te tjera	-	-
Fitime te pa shperndara	(48,340,529)	(42,585,899)
Fit/humbja e vitit	(5,854,956)	(5,754,630)
Totali	(54,095,485)	(48,240,529)

7. **Detyrime Afatshkurtra** ne vlere 76.002.240 leke perbehen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Te pagueshme ndaj punonjeseve	929,658	950,378
Te pagueshme ndaj furnitoreve	15,901,284	15,351,657
Te pagueshme ndaj ortakeve	58,979,000	52,499,000
Te pagueshme ndaj taksave	192,298	285,294
Totali	76,002,240	69,086,329

Detyrimet paraqiten me vleren e tyre per tu paguar me 31.12.2022.

7a. **Detyrimet fiskale:**

Llogarite e detyrimeve fiskale paraqiten me shumen per tu paguar Zyres se Tatimeve Tirane per llogarite Sigurime Shoqerore, TVSH dhe Tatim mbi te ardhurat personale.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Sigurime shoqerore	133,549	269,105
Tatim Page	5,721	16,189
TVSH	53,028	
Tatim Fitim i Pagueshem		
Totali	192,298	285,294

Detyrimet fiskale jane llogaritur drejte dhe sakte konform legjislacionit perkates.

“Gallery Albanian Restorant” Shpk Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

8. Te ardhurat nga aktiviteti perbehet nga te ardhurat nga shitja dhe qiradhenia e mallrave.

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Shitjet neto	9,720,633	7,458,027
Te Ardhura te Tjera		
Totali	9,720,633	7,458,027

9. Shpenzime per materiale. Perbehet nga kosto e blerjes se mallrave dhe shpenzimeve te tjera direkte

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Mallra e materiale te tjera	3,981,305	2,194,503
Mallra etj(te panjohura)	-	-
Totali	3,981,305	2,194,503

10. Shpenzime te tjera nga veprimtari e shfrytezimit.

Ne kete ze perfshihen shpenzime si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Sherbime te tjera	1,124,529	820,690
Sherbime te tjera(Te Panjohura)	2,423,118	2,980,938
Blerje Energji, Avull, Uje	1,018,222	908,012
Qira	-	1,803
Shpenzime per Licensa dhe Fiskalizim	28,583	10,250
Mirembajtje e riparime	790,154	43,567
Reklame e publicitet	31,702	51,973
Shpz.postare e telekom.	127,238	130,500
Sherbime bankare	38,805	115,880
Personel Jashte ndermarrjes	116,600	3,000
Taksa vendore	100,100	186,017
Taksa te tjera	900	1,500
VI.Kontabel e asetave te shitura		
Totali	5,799,951	5,254,130

11. Shpenzime te personelit.

Ne kete ze perfshihen shpenzime si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Paga	5,371,685	5,440,130
Sigurime shoqerore	897,081	941,697
Totali	6,268,766	6,381,827

“Gallery Albanian Restorant” Shpk Tirane
 Shenime per Deklarimet Financiare
 Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

12. Shpenzime Financiare.

Ne kete ze perfshihen te ardhura dhe shpenzime si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Fitim nga kembime valutore	2,166	1,684
Te ardhura financiare	472,267	626,520
Shpenzim nga kembime valutore		-
Shpenzime per interesa	-	(10,401)
Totali	474,433	617,803

13. Fitimi Neto

Fitimi neto eshte llogaritur si me poshte.

	<u>Viti 2022</u>	<u>Viti 2021</u>
Fitim Bruto	-5,854,956	-5,754,630
Shpenzime te pa njohura	2,423,118	2,980,938
Baza llogaritjes Tatimit	(3,431,838)	(2,773,692)
% e tatim Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	-	-
Fitimi NETO	(5,854,956)	(5,754,630)

